“Nuk ndodh që dy këmbët e një robi, të cilat pluhurosen në rrugën e Allahut, t'i prekë Zjarri.”

Ebu Absi, Abdurrahman ibn Xhebri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Nuk ndodh që dy këmbët e një robi, të cilat pluhurosen në rrugën e Allahut, t'i prekë Zjarri.”

[Sahih] [Transmeton Buhariu]

Profeti ﷺ në këtë hadith dha sihariq se atij që i mbulohen këmbët me pluhur, duke luftuar në rrugën e Allahut, Zjarri nuk do ta prekë.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3868